

**SHOQËRIA "XM" shpk**  
**Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

**V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë 22/04 /2021

Sot, më datë 22/04 /2021, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "XM" shpk, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82224013T, me zyrë qendore të shoqërisë në adresën: Tiranë, Vaqarr, Njësia Administrative Nr. 7, Pasuria me Nr. 4/14, Zona Kadastrale Nr. 3712.

Në mbledhjen e Asamblesë janë të pranishëm 2 ortakët e Shoqërisë:

1. **Znj. Milvia Simonetti**, shtetase italiane, lindur më 01.09.1962 në Recanati (MC) dhe banuese në Itali, në adresën: Via "Aputina", Nr. 134, Potenza Picena (MC), identifikuar me Letërnjoftimin Nr. AT 6452070, e cila zotëron **15% të kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk**;
2. **Shoqëria "CREO" Sha**, shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. NUIS L82223022N, përfaqësuar nga Administratori Z. Diego Puntillo, me zyrë qendore të shoqërisë në adresën: Njësia Administrative Nr.7, Rruga "Dritan Hoxha", Godina midis Tirana Ring Center dhe Pallatit të Sportit Asllan Rusi, Kati 5, Ap.46, Tiranë, Shqipëri, e cila zotëron **85% të kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk**.


Mbledhja e sotme ka rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Rritja e kapitalit të Shoqërisë "XM" Shpk, duke e bërë atë në vlerën totale **ALL 53,798,412 (pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë lekë)**, nëpërmjet kontributit të ortakëve në natyrë dhe në para, sipas Aktit të Ekspertimit të hartuar nga Eksperti Gëzim Jaupaj dhe konkretisht:

Ortaku	Vlera e kontributit shtesë në përputhje me përqindjen në kapital
Znj. Milvia Simonetti	Kontribut në para ALL 37,050 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë) Lekë
Shoqëria "CREO" Sha	Kontribut në natyrë ALL 18,004,862 (tetëmbëdhjetë milion e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy lekë)

2. Ndryshimi i përqindjes së pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin e shoqërisë;
3. Të tjera

Mbledhja u hap në orën 11:00, dhe u diskutuan pikat e rendit të ditës.



*Administrata Vasch*



Asambleja e Përgjithshme pasi mori në shqyrtim rendin e ditës,

#### KONSTATOI SE:

Ndërmjet shoqërisë XINGMAO SHOES (HONG KONG) dhe shoqërisë XM SHPK, ka patur një marrëdhënie furnizimi me makineri dhe pjesë të tjera përbërëse, sipas së cilës shoqëria XM SHPK ka qenë përfituese e tyre, kundrejt detyrimit të saj për të paguar çmimin prej USD 166,990 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë dollar), të detajuar sipas faturave: XM 20181113 prej USD 57,971; XM20181116 prej USD 18,019; XM20181205 prej USD 91,000.

Shoqëria XM SHPK nuk e ka paguar çmimin e këtyre faturave kundrejt shoqërisë XINGMAO SHOES (HONG KONG).

Nëpërmjet Marrëveshjes tre palëshe datë 28.11.2020 të lidhur ndërmjet shoqërisë XINGMAO SHOES (HONG KONG), shoqërisë REDDINGTON (HONG KONG) CO LTD dhe shoqërisë XM SHPK, shoqëria XINGMAO SHOES (HONG KONG) i ka transferuar shoqërisë REDDINGTON (HONG KONG) CO LTD të drejtën e kredisë të Debitorit XM SHPK për shumën totale prej USD 166,990.

Në kushtet kur detyrimi prej USD 166,990 rezulton i pa shlyer nga ana e debitorit XM SHPK, atëherë palët e kësaj marrëveshje kanë vendosur që të drejtën për të përfituar këtë shumë t'ia transferojnë shoqërisë CREO SHA.


Shoqëria CREO SHA, ka vendosur që të drejtën e përfituar sipas marrëveshjes së cedimit të kredisë datë 28.11.2020 për shumën USD 166,990 të konvertuar në lekë në vlerën ALL 18,004,862 (tetëmbëdhjetë milion e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy lekë) ta kalojë si kontribut të saj në natyrë në kapitalin e shoqërisë XM SHPK.

Po ashtu, ortakja zj. Milvia Simonetti ka vendosur që të shtojë kapitalin e saj në shoqërinë XM SHPK nëpërmjet rritjes së kontributit të saj në para në vlerën ALL 37,050 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë lekë).

Duke qenë se zmadhimi i kapitalit realizohet me kontributin e të dy ortakëve, ndryshohet në këtë mënyrë edhe konfigurimi aktual i strukturës së pronësisë dhe përqindjes së pjesëmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë.

Sa më sipër, ortakët kuptojnë se pas rritjes së kapitalit, kapitali i ri i shoqërisë do të jetë në vlerën totale ALL 53,798,412 (pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë lekë) lekë i zotëruar prej ortakëve si më poshtë, me ndryshimet përkatëse në përqindjen e pjesëmarrjes së secilit në kapitalin e ri të shoqërisë:

1. Znj. Milvia Simonetti, zotëruese e 1 (një) kuote, që do të përfaqësojë **10.29%** të kapitalit të ri me vlerë = **5,538,050** lekë
2. Shoqëria "Creo" Sha, zotëruese e 1 (një) kuote, që do të përfaqësojë **89.71%** të kapitalit të ri me vlerë = **48,260,362** lekë



Shumëtralla Vasile



Përfundimisht, në mbështetje të neneve 81 e vijues të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutit të Shoqërisë "XM" SHPK, pasi morri në shqyrtim rendin e ditës, me unanimitet,

*Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë*

**VENDOSI:**

1. Rritjen e kapitalit të shoqërisë me një shumë ALL 18,041,912 (tetëmbëdhjetë milion e dyzetë e një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) Lekë, nëpërmjet kontributit të ortakëve në para dhe në natyrë, sipas Aktit të Ekspertimit të hartuar nga Eksperti Gëzim Jaupaj dhe konkretisht:

ORTAKU	Përqindja %	Kuotat	Vlera e kapitalit
Creo Sha	89.71%	1	48,260,362 (ALL)
Milvia Simonetti	10.29 %	1	5,538,050 (ALL)

Kapitali total i regjistruar i shoqërisë "XM" shpk, pas rritjes, do të bëhet ALL 53,798,412 (pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë lekë)

Kapitali i shoqërisë "XM" shpk do të vazhdojë jetë i ndarë në 2 (dy) kuota, por përqindjet e pjesëmarrjes së dy ortakëve respektivë do të ndryshojnë, si më poshtë vijon:

- Ortaku znj. Milvia Simonetti, zotëruese e 1 (një) kuote, që do të përfaqësojë 10.29% të kapitalit të ri me vlerë = 5,538,050 lekë;
- Shoqëria "Creo" Sha, zotëruese e 1 (një) kuote, që do të përfaqësojë 89.71% të kapitalit të ri me vlerë = 48,260,362 lekë

2. Regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Duke mos patur çështje të tjera për diskutim nënshkruhet ky vendim rregullisht nga ortakët.

ORTAKET E SHOQËRISË "XM" Shpk

Milvia Simonetti  
MILVIA SIMONETTI



Shoqëria "CREO" Sha  
Diego Puntillo

Administratore  
Diego Puntillo



Diego Puntillo